

V E N D I M
Nr.573, datë 29.7.1998

**PËR SHPALLJEN E UJËMBLEDHËSIT TË BOVILLËS “OBJEKT TË RËNDËSISHËM
SHTETËROR”**

Në bazë të ligjit nr.7550, datë 20.1.1992 “Për policinë e objektit”, me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ujëmbledhësi i Bovillës shpallet “Objekt i rëndësishëm shtetëror” dhe merret në ruajtje nga Ministria e Rendit Publik, për t’u ruajtur me forcë policie.

Objekti i ruajtjes do të jetë diga e ndërtuar mbi lumin Tërkuzë, në grykën e ngushtë, në afërsi të fshatit Zall-Herr, nënobjektet, kullat, galeritë e marrjes së ujit, shkarkuesi automatik sipërfaqësor, galeria e kaptizhimit të ujit dhe tuneli i devijimit.

2. Marrja në ruajtje e objektit të bëhet në bazë të ligjit nr.7550, datë 20.1.1992 “Për policinë e objekteve”, neni 3, shkronja “b”, me marrëveshjen e Ministrisë së Rendit Publik dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe të Transportit.

3. Shpenzimet që nevojiten për efektivin e policisë për vitin 1998 e që arrijnë vlerën 1 789 348 lekë të përballohen nga fondet e Buxhetit të Shtetit, të akorduara për ndërtimin e veprës “Ujëmbledhësi i Bovillës”.

4. Për vitet në vazhdim fondet për ruajtjen e objektit do të përballohen nga subjekti që do ta ketë këtë objekt në administrim.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe të Transportit, Ministria e Rendit Publik dhe Bashkia e Tiranës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Pagesat për periudhën 1.8.1998 deri më 31.12.1998 (në bazë të urdhrit nr. 649, datë 28.3.1998 të Ministrit të Rendit Publik)

Për 8 policë	8 x 30 154 x 5	= 1 206 160 lekë
Për 1 oficer	1 x 34 475 x 5	= 172 375 lekë
Shuma 1		= 1 378 535 lekë

2. Tarifat për shpenzime operative:

- Për veshmbathje	11 126 lekë
- për pajisje armatimi	4 583 lekë
- për pajisje ndërlidhjeje	8 334 lekë
- për ushqim	18 750 lekë
Shuma	42 793 lekë/1 person, 5 muaj
	x 8

Shuma	342 344
TVSH 20%	68 469

Shuma 2	410 813 lekë
Shuma totale (1+2)	1. 789 348 lekë